


EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6587
E martë, 19 prill 2022
çmimi 0.40

Rreth 1 000 mijë
nxënës braktisën
shkollimin | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


ZYRTARË TË PARTISË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (PDK)
KANË MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE | FAQE 4-5

PDK-ja: MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS KEQPËRDORI MBI 9 MILIONË EURO NË 42 KONTRATA TË NEGOCIUARA



Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, ka thënë se nga 22 marsi 2021, pra nga dita e parë e qeverisë së udhëhequr nga Albin Kurti e deri më 7 prill të këtij viti, Ministria e Infrastrukturës ka keqpërdorur paratë e taksapaguesve përmes procedurës së shpërblimit e të marrëveshjeve nën tavolinë. Sipas tij, këto afere zbulojnë keqpërdorim të mbi 9 milionë eurove për 42 kontrata të negociuara nga Ministria e Infrastrukturës. Zëvendësministri i Infrastrukturës, Hysen Durmishi, ka reaguar ndaj këtyre akuzave, duke theksuar se përpjekja e PDK-së është e dobët dhe e dështuar

AKTUALE



BRITANIA: REZISTENCA
E MARIUPOLIT PENGON
PËRPARIMIN RUS NË UKRAINË | F. 2

KURTI: ASNJË GRAM TOLERANCË
PËR STRUKTURAT ILEGALE TË
SERBISË NË KOSOVË | F. 6

16 RASTE TË REJA ME COVID NË
KOSOVË | F. 3

EKONOMI



QEVERIA KUNDËR TËRHEQJES
SË KURSIMEVE NGA TRUSTI:
NUK ËSHTË ZGJIDHJE | F. 3

CILI DO TË JETË MANDATI I BYROSË
PËR KONFISKIMIN E PASURISË? | F. 7

SPORT



UEFA: KAMPIONI I SUPERLIGËS SË
KOSOVËS LUAN DIREKT NË RAUNDIN
E PARË TË CHAMPIONS-it | F. 11

Gazetarja ukrainase:
Putini nuk dëshiron
që bota të dijë çfarë
po ndodh në Ukrainë

FAQE 6



KONJUFCA: SERBIA ËSHTË
PËRGJEGJËSE PËR MBI
300 MASAKRA NË KOSOVË

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Britania: Rezistenca e Mariupolit pengon përparimin rus në Ukrainë

LONDËR, 18 PRILL - Ministria e Mbrojtjes e Britanisë ka njoftuar se rrethimi i vazhdueshëm i qytetit-port të Mariupolit, në juglindje të Ukrainës, po i pengon dhe ngadalëson forcat ruse në përparimin e tyre, përpara një ofensive të madhe të planifikuar në Ukrainën lindore. "Rezistenca ukrainase ka testuar ashpër forcat ruse dhe ka devijuar forcat dhe materialet, duke ngadalësuar

përparimin e Rusisë gjetkë", ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes në përditësimin e rregullt lidhur me luftën në Ukrainë.

Britania ka njoftuar më 18 prill se "komandantët rusë do të shqetësohen për kohën që do t'u duhet për të marrë" qytetin, ku ushtarët ukrainas ende po rezistojnë pavarësisht prej sulmeve intensive ruse.

Qyteti i Mariupolit përballur me sulme ruse për javë të tëra që kanë shkaktuar numër "të

konsiderueshëm" të viktimave dhe dëmeve në infrastrukturë. Ministria e Mbrojtjes e Britanisë e ka akuzuar Rusinë se po përdor taktika të ngjashme të luftës gjithëpërfshirëse në zonat civile, siç kishte bërë në Çeçeni dhe Siri, pavarësisht se Moska kur nisi pushtimin e paprovokuar të Ukrainës më 24 shkurt, ka thënë se "Rusia nuk do të godiste qytete dhe as nuk do ta kërcënonte popullatën ukrainase".



Kryetari i Moskës: 200 000 vende pune në rrezik pas largimit të kompanive perëndimore

MOSKË, 18 PRILL - Rreth 200 000 persona rrezikojnë ta humbasin vendin e tyre të punës në kryeqytetin rus, Moskë, për shkak se kompanitë perëndimore kanë pezulluar operacionet e tyre në Rusi për shkak të sanksioneve të vendosura për pushtimin e Ukrainës, ka thënë kreu i qytetit, Sergei

Sobyanin.

Javën e kaluar autoritetet ruse miratuan një program prej 41 milionë dollarësh për ta ndihmuar punësimin në Moskë. Ky program ka për qëllim të ofrojë trajnime dhe punë të përkohshme, ka shkruar Sobyanin në blogun e vet.

Qindra kompani perëndimore



kanë njoftuar se do t'i pezullojnë operacionet e tyre në Rusi pasi Perëndimi

vendosi një sërë pakosh të sanksioneve kundër Moskës për shkak të pushtimit të paprovokuar të Ukrainës. Sobyanin ka thënë se programi i ri synon që t'i mbështesë mbi 58 000 persona që kanë humbur vendet e punës pasi kanë punuar për kompani të huaja. Ai ka shtuar se 12 500 prej tyre do të trajnohen.

Kryetari i Moskës ka thënë se punët që do të ofrohen do të përfshijnë punë publike siç janë disa organizata të qyteteve dhe të tjera.

Ekspertët parashikojnë se ndikimi më i madh ekonomik i sanksioneve perëndimore ende nuk është ndier në Rusi dhe ata presin që Moska të futet në recesion të thellë.

Turqia nis ofensivë të re kundër militantëve kurdë në Irak

ANKARA, 18 PRILL - Turqia ka nisur një ofensivë të re ajrore dhe tokësore kundër militantëve kurdë në veri të Irakut, ka njoftuar më 18 prill ministri i Mbrojtjes, Hulusi Akar.

Njësitë ushtarake dhe forcat speciale, të mbështetura nga një numër i paspecifikuar i avionëve dhe helikopterëve, janë përfshirë në ofensivën kundër Partisë së Punëtorëve të Kurdistanit (PKK) në rajonet

Metina, Zap dhe Avashin-Basyan, që gjenden në veri të Irakut, ka bërë me dije Akar.

PKK konsiderohet organizatë terroriste nga Turqia, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. Kjo organizatë po kryen një kryengritje kundër shtetit turk që prej vitit 1984.

Turqia vazhdimisht kryen sulme në Irak, ku PKK ka bazat dhe kampet trajnuese në rajonin Sinjar, që gjendet në kufi me Turqinë. "Pilotët tanë me sukses

kanë goditur strehimoret, shpellat, tunelet dhe depot e municionit që i përkasin organizatës terroriste", ka thënë Akar.

Ai nuk ka treguar se sa trupa janë përfshirë në këtë operacion, i cili, sipas Akar, nisi mbrëmjen e së dielës.

Ministria e Mbrojtjes e Turqisë ka thënë se operacioni nisi pasi është zbuluar se PKK po planifikonte një sulm të shkallës së gjerë kundër Turqisë.



Zelensky, bisedë me homologun lituanëz: Kërkojmë mbështetjen e vendeve evropiane

KIEV, 18 PRILL - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka zhvilluar të hënën bisedë telefonike me presidentin e Lituaniës, Gitanas Nauseda.

Zelensky e ka bërë publike këtë bisedë në "Twitter", ku është shprehur se e ka informuar homologun lituanëz mbi situatën në Ukrainë. Ai ka shtuar se shpreson të rritja e mbështetjes së vendeve

evropiane ndaj Ukrainës në këtë luftë

Zelensky e ka akuzuar Rusinë se dëshiron ta 'fshijë nga faqja e dheut' të gjithë rajonin lindor të Donbasit, ndërsa forcat ukrainase po përgatiten për betejën finale për ta mbrojtur qytetin e Mariupolit. "Trupat ruse po përgatiten për një operacion të madh për ta sulmuar lindjen e vendit tonë.



Sulmi do të fillojë së shpejti. Ata duan të shkatërrojnë të gjithë

Donbasin, të shkatërrojnë gjithçka që dikur i ka dhënë emër këtij rajoni. Ashtu siç po shkatërrojnë Mariupolin, ata duan të fshijnë nga faqja e dheut edhe qytetet e tjera në rajonet e Donetskut dhe Luhanskut", ka thënë ai. Zelensky u ka bërë thirrje ukrainasve të mos i dëgjojnë urdhrat e pushtuesve. "Injorojini urdhrat e

pushtuesve. Mos bashkëpunoni me ta. Protestoni. Është e nevojshme të rezistojmë në mënyrë që Rusia të mos arrijë t'i shkatërrojë jetët tona në qytetet e tjera të Ukrainës siç bëri në Donetsk dhe Luhansk", ka theksuar ai.

Presidenti ukrainas përsëriti thirrjen që Perëndimi të vendosë "një embargo të plotë të naftës nga Rusia".

Qeveria kundër tërheqjes së kursimeve nga Trusti: Nuk është zgjidhje

PRISHTINË, 18 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është deklaruar kundër tërheqjes së kursimeve nga Fondi Pensional (Trusti), duke thënë se "kjo nuk është zgjidhje". Sipas Kurtit, mendim të njëjtë kanë edhe ekspertët e Fondit Monetar Ndërkombëtar. "Kemi thënë edhe shumë më herët, kur ishim në opozitë, edhe tani, me Pakon e Ringjalljes Ekonomike do ta zbusim krizën. Por, nuk konsiderojmë që duke marrë nga pleqëria individuale e punëtorëve mund ta zgjidhim problemin. Edhe dy ekspertë të FMN-së e kanë dhënë vlerësimin, se një zgjidhje e tillë nuk është zgjidhje", ka deklaruar Kurti pasi ka bërë homazhe te shtatorja e heroit Zahir Pajaziti në Prishtinë. Qytetarët e Kosovës së fundmi janë përballur me rritje të çmimeve të produkteve ushqimore bazë

dhe të derivateve e shërbimeve të tjera. Për t'i ndihmuar qytetarët që ta tejkalojnë më lehtë krizën ekonomike të shkaktuar, Partia Demokratike e Kosovës ka propozuar tërheqjen deri në 30 për qind të kursimeve pensionale. Deputeti i kësaj partie, Bekim Haxhiu, në emër të grupit parlamentar më 9 mars ka dorëzuar në Kuvend Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Fondin e Kursimeve Pensionale, i cili do ta mundësonte tërheqjen e këtyre mjeteve. Një tërheqje e ngjashme deri në 10 për qind është bërë në fund të vitit 2020, pas përkeqësimit të gjendjes financiare të familjeve, për shkak të pandemisë Covid-19. Në raportin e gjashtëmujorit të parë të 2021-s Trusti ka njoftuar se janë tërhequr rreth 200 milionë euro nga më shumë se 427 mijë kontribuues.



Konjufca: Serbia është përgjegjëse për mbi 300 masakra në Kosovë

"Epoka e re"

PODUJEVË, 18 PRILL - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, i shoqëruar nga kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka bërë homazhe të hënën në kompleksin memorial në fshatin Dyz të Podujevës si dhe në fshatin Ribar i Vogël të Lipjanit. Konjufca, po ashtu, ka marrë pjesë në tubimin përkujtimor, në shënim të 23-vjetorit të masakrës në fshatin Dyz, gjatë së cilës qenë vrarë dhe masakruar rreth 70 civilë shqiptarë, si dhe qindra të vrarë të tjerë në shumë fshatra të Llapit e të Gollakut. Në fjalimin e mbajtur në kujtim të të rënëve, kryetari Konjufca ka thënë se për këto masakra dhe vrasjen e mbi 12 mijë shqiptarëve të Kosovës, përgjegjësi kryesor është shumë i qartë: shteti i Serbisë, me ushtri, me polici, me aparat



shtetëror dhe me paramilitarët që i ka kontrolluar dhe urdhëruar për të gjitha këto krime, në mbi 300 masakra të kryera anekënd Kosovës. Konjufca ka thënë se historikisht populli shqiptar ka përjetuar gjenocid nga Serbia. "Krimi i parë ishte vrasja e vëllezërve dhe motrave tona,

duke mos i kursyer as fëmijët. Krimi i dytë ishte pas vrasjes: marrja dhe fshehja nëpër Serbi edhe sot e kësaj dite. Krimi i tretë është që deri më tani nuk ka pasur drejtësi për asnjë nga këto që kanë ndodhur. Krimi i katërt është se Serbia ende nuk ka ndryshuar qëndrimin e saj në raport me Kosovën", ka

thënë Konjufca. Kreu i Kuvendit ka shtuar se Serbia po i bën homazhe ish-udhëheqësit të vet që la pas vetes qindra mijëra të vrarë. "Ne po u bëjmë homazhe të rënëve që kanë derdhur gjakun për liri, ndërsa Serbia po i bën homazhe kasapit të vet që i la të vdekur mbi 160 mijë

qytetarë të popujve të ndryshëm, shqiptarë, boshnjakë dhe kroatë", ka thënë kryetari i Kuvendit, duke shtuar se Kosova çdoherë do t'i nderojë dhe kujtojë të rënët për liri. Në tubimin përkujtimor fjalë rasti ka mbajtur edhe kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ish-komandanti i UÇK-së për Zonën Operative të Llapit, Rustem Mustafa, Ali Podvorica në emër të famljeve të të rënëve dhe Bedri Llapashtica në emër të Këshillit Organizativ të fshatit Dyz. Në fund të tubimit kryetari Konjufca ka marrë pjesë në mbjelljen e 227 drunjeve për nder të 227 të rënëve në muajin prill të vitit 1999 në territorin e Llapit dhe Gollakut. Konjufca ka bërë homazhe dhe vendosur lule edhe në kompleksin memorial në Ribar të Vogël të Lipjanit, në nderim të 25 civilëve shqiptarë të vrarë 23 vjet më parë.

16 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 18 PRILL (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 589 testimeve, 16 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të hënën janë

shënuar 25 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shënuarve është 224 267. Në total numri i rasteve aktive është 472. Në 24 orët e fundit janë dhënë 20 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e

Kosovës janë dhënë 1 824 575 doza të vaksinës. Deri më sot 821 438 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 100 906 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.





ZYRTARË TË PARTISË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (PDK) KANË MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE

PDK-ja: Ministria e Infrastrukturës keqpërdori mbi 9 milionë euro në 42 kontrata të negociuara

Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, ka thënë se nga 22 marsi 2021, pra nga dita e parë e qeverisë së udhëhequr nga Albin Kurti e deri më 7 prill të këtij viti, Ministria e Infrastrukturës ka keqpërdorur paratë e taksapaguesve përmes procedurës së shpërblimit e marrëveshjeve nën tavolinë. Sipas tij, këto afere zbulojnë keqpërdorimin e mbi 9 milionë eurove për 42 kontrata të negociuara nga Ministria e Infrastrukturës. Zëvendësministri i Infrastrukturës, Hysen Durmishi, ka reaguar ndaj këtyre akuzave, duke theksuar se përpjekja e PDK-së është e dobët dhe e dështuar

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 PRILL - Kryetari i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, bashkë me deputeten Eliza Hoxha dhe anëtarin e kryesisë, Bernard Nikaj, kanë denoncuar të hënën para gazetarëve dyshimet për aferat korruptive të Ministrisë së Infrastrukturës. Këto afere zbulojnë keqpërdorim të mbi 9 milionë eurove për 42 kontrata të

negociuara nga Ministria e Infrastrukturës.

Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, ka thënë se nga 22 marsi 2021, pra nga dita e parë e qeverisë së udhëhequr nga Albin Kurti e deri më 7 prill të këtij viti, Ministria e Infrastrukturës ka keqpërdorur paratë e taksapaguesve përmes procedurës së shpërblimit e të marrëveshjeve nën tavolinë.

“Ministria e udhëhequr nga Liburn Aliu dhe Hysen

Durmishi për një vit ka nënshkruar 42 kontrata njëburimore, apo 42 kontrata të negociuara, pa konkurrencë. Vlera e tyre në total arrin mbi 9 milionë euro. Pra, mjafton të shikojmë në të kaluarën dhe ky është një rast i paprecedent”, ka thënë ai.

Tahiri ka theksuar se në Ministrinë e Infrastrukturës nuk ka pasur procese prokurimi, por tenderomani pa procedura tenderësh. “Prej 42 projekteve, prej të cilave 41 janë punë shtesë dhe një është

projekt i ri, të kenë nevojë të gjitha për punë shtesë, këtu veçse kemi të bëjmë me një aferë të pastër korruptive dhe me keqpërdorim të 9 milionë eurove nga pushtetarët aktualë”, ka potencuar ai.

Ndërsa deputetja e PDK-së, Eliza Hoxha, ka argumentuar shkeljet e Ligjit për Prokurimin Publik, të bëra nga Ministria e Infrastrukturës, ku 90 % e kontratave të lidhura e kanë tejkaluar vlerën e kontratës, duke i shkaktuar dëme buxhetit shtetëror prej 10 % të vlerës së kontratave bazë. Ajo ka theksuar se shumica e këtyre kontratave janë nënshkruar nga zëvendësministri Hysen Durmishi, derisa legjislacioni në fuqi nuk e parasheh këtë.

“Në kontratat e nënshkruara brenda kësaj periudhe njëvjeçare Ministria e Infrastrukturës ka eliminuar

konkurrencën e lirë dhe ka diskriminuar operatorët ekonomikë. Shkelje tjetër ligjore në këto kontrata është edhe mosplanifikimi i aktiviteteve të prokurimit, siç përcaktohet në nenin 8 të ligjit. Sepse gjatë periudhës 22.03.2021 – 07.04.2022 procedura e negociuar pa publikim të kontratës është përdorur 42 herë, që nënkupton se menaxhimi dhe planifikimi vjetor rreth procedurave të prokurimit ka qenë thjesht një dështim, ku shumica e këtyre kontratave janë punë shtesë apo 10 % të kontratave bazë. Vlera e kontratave gjatë përdorimit të kësaj procedure në periudhën njëvjeçare arrin vlerën rreth 9 milionë euro”, ka thënë deputetja Hoxha.

Ndërsa anëtari i kryesisë i PDK-së, Bernard Nikaj, ka thënë se kjo është një super

Rreth 1 000 mijë nxënës braktisën shkollimin

PRISHTINË, 18 PRILL - 109 nxënës nga klasa e parë e deri në të nëntën dhe 883 të tjerë të shkollave të mesme kanë braktisur shkollimin gjatë vitit të kaluar. Tash 1 600 mësimdhënës janë më tepër sesa nevojiten në sistemin e arsimit.

Ministria e Arsimit do t'u rekomandojë komunave që të kenë kujdes me zëvendësimin e mësimdhënësve që dalin në pension, duke i risistemuar ata që aktualisht janë të punësuar. Janë rreth 400-500 mësimdhënës të cilët gjatë vitit pensionohen, për të cilët edhe njohësit e fushës së arsimit, thonë se zgjidhja më e duhur do të ishte risistemimi i atyre

që janë të inkuadruar në sistemin arsimor.

Zëvendësministri i Arsimit, i Shkencës, i Teknologjisë dhe i Inovacionit, Dukagjin Pupovci, ka thënë për "KosovaPress" se edhe vitin e kaluar ka pasur tepricë të mësimdhënësve por, siç ka treguar ai, për ta ruajtur këtë numër të mësimdhënësve duhet punuar me klasa të vogla. "Është konstatuar se për këtë vit teprica është 1 298 mësimdhënës dhe kjo është një situatë të cilën e kemi gjetur nëpër shkolla. Është e vërtetë se kjo tepricë vitin tjetër rritet për shkak të zvogëlimit të numrit të nxënësve. Për ta ruajtur këtë numër të mësimdhënësve

punohet me klasa më të vogla. Për shembull, nëse formohet një klasë me 30 nxënës, formohen dy klasë me nga 15 nxënës, kjo pastaj bën të mundur që ky numër i mësimdhënësve të mbetet në sistem", ka theksuar Pupovci. Pupovci ka folur edhe për adresimin e këtij problemi, duke thënë se që nga viti i ardhshëm do t'u kërkojnë komunave që mos t'i zëvendësojnë mësimdhënësit e pensionuar pa një analizë të mirëfilltë. Sipas tij, braktisja më e dëmshme është kur fëmijët braktisin shkollimin e detyruar. Ai ka përmendur edhe arsyet e nxënësve që braktisin shkollën. "Në

shkollimin e detyruar, për shembull, vitin e kaluar kemi pasur 109 nxënës të cilët e kanë braktisur ose 0.05 %, pra janë klasat një deri në nëntë. Braktisja është më e ndjeshme në këtë moshë sepse bëhet fjalë për shkollim të detyruar. Ndërkaq vitin e kaluar në arsimin e mesëm kemi pasur 883 braktisës. Është numër më i madh, ose 1.19 %. Kryesisht bëhet fjalë për gjininë mashkullore dhe kryesisht bëhet fjalë për shkaqe ekonomike. Pra në arsimin e detyruar kjo ndodh për shkak se këta fëmijë duhet të angazhohen për ta ndihmuar familjen e vet ose ndodh për shkak të rasteve kur familja e

neglizhon vijimin e rregullt të fëmijës. Në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të ulëta ekzistojnë ekipet për parandalim të braktisjes dhe reagim ndaj braktisjes, të cilat në situata të tilla ndërmarin hapa, duke shkuar nëpër shtëpi që t'i bindin prindërit që t'i kthejnë fëmijët në shkollë. Kjo është arsyeja pse ky numër është relativisht i vogël, sepse kemi një reagim të menjëhershëm. Mirëpo, megjithatë, braktisje ka, është në një shkallë të vogël, por ka. Sa i përket shkollimit të mesëm, situata qëndron më ndryshe. Ata i braktisin shkollat profesionale dhe i braktisin kur gjejnë punë", ka thënë ai.



afër e qeverisë Kurti, në të cilën pushtetarët kanë ndarë nën tavolinë mbi 9 milionë euro nga taksat e qytetarëve. "E gjithë kjo ndërmarrësi korruptive e bën shumë të qartë se nuk kemi të bëjmë me procese prokurimi. Kemi të bëjmë me fenomenin e pastër të tenderomanisë. Dhe, për më keq, tenderomanisë pa procese e procedura tenderësh të hapur. Shkeljet e evidentuara dhe abuzimi me paranë publike në këtë rast, përbëjnë vepër të pastër penale dhe, mbi këtë bazë, PDK-ja do të përgatitë kallëzim penal për secilin të përfshirë në këto vepra", ka theksuar Nikaj.

Durmishi: Vetëm një kontratë e negociuar, të tjerat janë të nënshkruara nga qeverisjet e kaluara

Zëvendësministri i Infrastrukturës, Hysen Durmishi, ndaj këtyre akuzave ka reaguar në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka shkruar se "përpjekja e PDK-së për të na bërë të dukemi si ajo është e dobët dhe e dështuar". "Kjo mënyrë e qeverisjes së drejtë si duket po u pengon shumë atyre që nuk lanë asnjë të zezë pa e bërë. Asnjë shkelje të ligjit nuk e kemi bërë, e nuk e kemi asnjë afërë korruptive, e për më shumë kujdesemi në maksimum për

paranë publike, gjë që është e pakuptueshme për qeverisjet e kaluara e sidomos për PDK-në, që e zhvati shtetin për vite me radhë", ka thënë Durmishi. Ai ka theksuar se është vetëm një kontratë e negociuar e lidhur nga MMPHI-ja, për projektin e "Zgjatjes së pistës së aeroportit Adem Jashari", projekt ky i ndërprerë për shkak të pandemisë. "Sot pista e aeroportit është e zgjatur, janë instaluar mjete navigimi që aeroportin tonë e bëjnë më të sigurtin në Ballkan. Të gjitha kontratat e tjera janë të nënshkruara nga qeverisjet e kaluara, me gabime të mëdha, në projekte, paramasa, pozicione të paparashikuara,

duke lënë gjithmonë hapësirën për penallti, pra ku ministria obligohet të paguajë dëmshpërblime milionëshe pa asnjë punë të kryer. Ndërkohë në terren përballemi me një gjendje jo të mirë të rrugëve për shkak të punimeve të ndërprera. Në mënyrë që t'i përfundojmë këto kontrata kemi nënshkruar anekskontratat për punë shtesë, të gjitha sipas legjislacionit në fuqi dhe në përpikëri me të", ka deklaruar Durmishi. Ai ka pyetur se kush janë këta që po akuzojnë e që po shpifin? "PDK, që nuk ka lënë gjë pa bërë duke abuzuar me pushtetin. Vetëm një dëshmi po

jua jap, që tregon se si qeverisim në vendin tonë dhe sa kujdesemi për paranë publike. Mirëmbajtja verore e dimërore për rrugët regjionale e nacionale qeverisjeve të kaluara u ka kushtuar 19 milionë euro në vit. Në qeverisjen tonë për një vit për rrugët e njëjta vetëm 9 milionë euro. Edhe më lirë e natyrisht edhe më mirë. Kjo parti është në hall me xhepin e saj që e kishte të lidhur me buxhetin e shtetit. Qeverisja e keqpërdorimit të buxhetit të shtetit ka marrë fund dhe nuk kthehet më. Natyrisht që për të gjitha këto shpifje ne do të ngrehim padi në organet e drejtësisë", ka thënë Durmishi.

Gazetarja ukrainase: Putini nuk dëshiron që bota të dijë çfarë po ndodh në Ukrainë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 18 PRILL - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, nuk dëshiron që bota ta dëgjojë të vërtetën për atë që po ndodh në Ukrainë, prandaj ushtarët rusë po vrasin gazetarët, tha Lyudmila Makey, gazetarja e parë ukrainase që është strehuar në Kosovë. Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës njoftoi se edhe tre gazetarë ukrainas kanë shprehur interesimin që të vijnë në Kosovë.

Në një konferencë për medie në Prishtinë, ajo tha se të paktën 21 gazetarë në Ukrainë janë vrarë dhe 25 të tjerë janë të zhdukur në qytetin e Mariupolit qëkur Rusia nisi pushtimin e paprovokuar të Ukrainës më 24 shkurt.

Makey ka shprehur mirënjohje për mbështetjen e dhënë nga Kosova si dhe për solidarizimin e gazetarëve për luftën në Ukrainë. "Sapo zbrita nga aeroplani e ndjeva sinjeritetin dhe mikpritjen e njerëzve që më takuan. Më ka bërë përshtypje tej mase se si dhimbja e vendit tim ndihet në zemrën e popullit të Kosovës. Jam mirënjohëse ndaj Qeverisë së Kosovës për mbështetjen ndaj popullit të Ukrainës në një moment kaq të vështirë, si dhe për solidarizimin e kolegëve nga Kosova sepse është shumë e rëndësishme që bota të dëgjojë për Ukrainën", ka thënë ajo në një konferencë për medie mbajtur në selinë e AGK-së.

Makey, gjithashtu, tha se ndihet



tejet e nderuar që po përfaqëson Unionin e Gazetarëve të Ukrainës që ka mbi 16 mijë anëtarë, si dhe që po i jepet mundësia të raportojë nga Kosova. "Jam sinjerisht mirënjohëse për mundësinë që të bëhem gazetarja e parë ukrainase që vjen në Kosovë. Për mua kjo është mundësi e mirë për të qëndruar në profesion dhe për t'i njohur kolegët gazetarë në Kosovë", ka thënë ajo.

Kryetari i AGK-së, Xhemajl Rexha, tha se ndihet krenar me punën që është bërë deri më tani për akomodimin e kolegëve nga Ukraina, si dhe për vullnetin e kolegëve e medieve nga Kosova

për t'u ofruar hapësirë pune gazetarëve që do të vijnë në Kosovë. "Hapësira e AGK-së do të shërbejë për gazetarët e parë si vend pune, njëherësh falënderojmë të gjithë kolegët dhe mediet e tjera që kanë shprehur gatishmëri për të ofruar hapësirë për punë për kolegët nga Ukraina. Ky është një projekt shumë i rëndësishëm për AGK-në, është solidaritet në vepër dhe jam shumë krenar me punën që është bërë dhe do të bëhet, dhe me gjithë vullnetin e gazetarëve, kolegëve për t'i ndihmuar gazetarët nga Ukraina", tha ai.

Flutura Kusari nga ECPMF tregoi

se, përveç buxhetit që është ndarë për akomodim të gazetarëve ukrainas, shpenzimeve mujore dhe udhëtimit, kolegëve nga Ukraina u janë siguruar edhe kurse të gjuhës shqipe, shërbime mjekësore dhe psikosociale.

"Me buxhetin që është ndarë, që është 150 mijë euro për gjashtë muaj, gazetarët që do të vijnë në Kosovë do të marrin 500 euro në muaj për shpenzime mujore, 300 euro për qira të banesës dhe rreth 1 000 euro për udhëtim për të ardhur në Kosovë, dhe për t'u kthyer në vendin e tyre kur të vijë koha e duhur. Ne, po ashtu, kemi siguruar shërbime

mjekësore, shërbime psikosociale, kurse të gjuhës shqipe dhe kurse të integritimit. Po ashtu, falë AGK-së dhe medieve të tjera kemi siguruar zyrë dhe redaksi ku gazetarët do të mund të punojnë", tha Kusari. Ajo njoftoi se roli kryesor i ECPMF-së së bashku me Federatën Evropiane të Gazetarëve është verifikimi i gazetarëve që aplikojnë për t'u bërë pjesë e programit "Gazetarët në Rezidencë në Kosovë". "Roli i Qendrës Evropiane për Liri të Shtypit dhe të Medies dhe EFJ-së është pranimi i kërkesave të gazetarëve nga Ukraina dhe verifikimi i tyre. Ne duam të sigurohemi që gazetarët që vijnë në Kosovë janë gazetarë të cilët njihen në Ukrainë dhe këtë e bëjnë në bashkëpunim me dy Unionet e Gazetarëve në Ukrainë", tha ajo.

"Gazetarë në Rezidencë në Kosovë" është program i iniciuar nga Qendra Evropiane për Liri të Shtypit dhe Medias (ECPMF) dhe Federata Evropiane e Gazetarëve (EFJ), i financuar dhe mbështetur nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Ministria e Punëve të Brendshme. Programi është duke u zbatuar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës me mbështetjen e OSBE-së dhe European Endowment for Democracy, si dhe në bashkëpunim me dy unionet e gazetarëve në Ukrainë.

Kurti: Asnjë gram tolerancë për strukturat ilegale të Serbisë në Kosovë

PRISHTINË, 18 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka quajtur "sulm terrorist" sulmin ndaj pjesëtarëve të Policisë së Kosovës në veri të vendit më 15 prill, duke shtuar se nuk do të ketë "asnjë gram tolerancë" nga qeveria për strukturat ilegale të Serbisë në Kosovë.

Duke folur me gazetarët në Prishtinë më 18 prill, pas homazheve pranë bustit të Zahir Pajazitit, Kurti tha se u takon organeve të rendit që ta hetojnë dhe të vlerësojnë situatën e sigurisë, pas disa sulmeve të raportuara ndaj policisë në veri të Kosovës. "Është Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës ato që i bëjnë analizat, studimet edhe të shkaqeve dhe të rrethanave të këtyre sulmeve mbi pjesëtarët tanë të policisë. Ne e kemi dënuar ashpër këtë sulm, i cili ishte sulm terrorist meqenëse me plumba, me granata u gjuajtën pjesëtarët e policisë, të cilët patën fat që në veturat e tyre pësuan vetëm dëme materiale", tha Kurti.

Ai tha se sulmi i 15 prillit, kur sipas autoriteteve të rendit në Kosovë, policët ishin sulmuar teksa ishte nisur për ta marrë detyrën në pikat kufitare me Serbinë, kishte për qëllim t'i vriste policët. "Me strukturat ilegale të Serbisë, me krimin e organizuar, kurrë nuk do të ketë asnjë gram tolerancë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nga shteti i Kosovës, nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe nga Policia e Kosovës", tha Kurti.

Më 15 prill ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, tha se Policia e Kosovës ishte përballur me një sërë sulmesh në veri të Kosovës, të banuar me shumicë serbe.

Sveçla tha se këto sulme kanë për qëllim që ta destabilizojnë Kosovën.

Më 16 prill Policia e Kosovës njoftoi se sërish ishte sulmuar me mjete shpërthyes në afërsi të pikëkalimit kufitar në Jarinjë që lidh Kosovën dhe Serbinë.

Policia e Kosovës në muajin shkurt kishte njoftuar se ka nisur



të mbyllë disa rrugë që shfrytëzohen për kontrabandë në veri të Kosovës. Ndërkaq, në tetorin e vitit të kaluar zyrtarët policorë kishin zhvilluar një

aksion të gjerë kundër kontrabandës në rajonin e Prishtinës, Pejës, Mitrovicës së Jugut dhe Mitrovicës së Veriut. Sulmet e fundit ndaj Policisë së

Kosovës i kanë dënuar edhe Ambasada Amerikane në Prishtinë, Bashkimi Evropian dhe misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR-i.

Cili do të jetë mandati i Byrosë për Konfiskimin e Pasurisë?



PRISHTINË, 18 PRILL - Të gjithë zyrtarët publikë në Kosovë mund të jenë subjekt i verifikimit të pasurisë nëse ekzistojnë dyshime se ajo është fituar në mënyrë të kundërligjshme. Përveç tyre, verifikimi dhe konfiskimi i pasurisë së pajustificueshme do të bëhet edhe për anëtarët e familjes së tyre dhe palët e treta, që nënkupton personat te të cilët dyshohet se është bartur pasuria e zyrtarëve publikë. E gjithë kjo mund të fillojë të bëhet nëse themelohet Byroja Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Për krijimin e kësaj byroje nevojitet miratimi i ligjit për krijimin e Byrosë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Një ligj të tillë Qeveria e Kosovës e ka miratuar në dhjetor të vitit 2021. Në muajin shkurt të këtij viti është dërguar për miratim në Kuvendin e Kosovës. Në Kuvend nuk është hedhur në votim, pasi deputetë të partive opozitare kanë kërkuar që projektligji të adresohet në Komisionin e Venecias. Ata nuk janë pajtuar që kjo byroja të udhëhiqet vetëm nga një drejtor. Ata kanë shprehur shqetësimin se krijimi i byrosë është tendencë për krijim të institucioneve paralele gjyqësore. Zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë kanë konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" se projektligji është dërguar në Komisionin e Venecias për opinion. Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka deklaruar për televizionin KTV këtë javë se në muajin qershor pritet që

Komisioni i Venecias të japë një qëndrimin rreth projektligjit dhe më pas i njëjti do të dalë para Kuvendit.

Komisioni Evropian për Demokraci Njëpërmjet Ligjit, i njohur si Komisioni i Venecias, është një organ këshillues dhe joobligativ mbi çështjet kushtetuese.

Çfarë parasheh projektligji?

Siç thuhet në projektligj, ai zbatohet ndaj pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme nga personat zyrtarë, personat e ekspozuar politikisht, anëtarët e tyre të familjes dhe palët e treta. Projektligji përfshin periudhën nga data 17 shkurt 2008 dhe periudhën brenda dhjetë vjetësh nga koha kur zyrtarët publikë pushojnë së ushtruar funksionin e tyre. Persona të ekspozuar politikisht nënkupton personat fizikë të huaj apo vendorë të cilët janë ose kanë qenë të ngarkuar me funksione të larta publike. Pasuria do t'u verifikohet edhe anëtarëve të familjes, bashkëshortit/es, fëmijëve, prindërve, vëllezërve, motrave dhe palëve të treta. Sipas legjislacionit, byroja ka kompetencat dhe përgjegjësitë për ta zhvilluar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe parashtron propozimin për konfiskim të pasurisë në gjykatë.

Fuqia e drejtorit të byrosë

Projektligji thotë se byroja udhëhiqet nga drejtori i

përgjithshëm që votohet nga Kuvendi i Kosovës me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm. Votimi për zgjedhjen e drejtorit bëhet në mënyrë të fshehtë. Mandati i drejtorit është pesëvjeçar. Sipas projektligjit, për fillimin e procedurës për verifikim vendos drejtori i byrosë, pastaj byroja vazhdon mbledhjen dhe hulumtimin e dokumentacionit relevant për rastin.

Në rast se nga të dhënat e mbledhura dëshmohet mospërputhje në mes të të hyrave dhe pasurisë që tejkalon vlerën prej 25 000 eurosh, atëherë zyrtari i byrosë propozon dërgimin e çështjes për konfiskim në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Ky propozim i dorëzohet drejtorit të përgjithshëm, i cili më pas parashtron propozim për konfiskim.

Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se askush nuk duhet të frikësohet nga ky projektligj. "Ky institucion merret vetëm me shpërputhjen në mes të të ardhurave të një zyrtari dhe pasurisë që ka. Ngrihen ata flamujt e kuq kur ka dyshime se dikush e ka pasurinë që nuk mund ta justifikojë, dhe [byroja] i thotë a mund të tregosh si e ke blerë banesën në qytetin e Durrësit [Shqipëri] ose në vende të tjera bregdetare. Ligji do t'i trajtojë edhe rastet kur dyshohet që një pasuri ka dalë në emër tjetër kujt", ka thënë Haxhiu.

IKD: Projektligji përmban të meta juridike

Ndërsa Instituti i Kosovës për

Drejtësi (IKD) vlerëson se qëllimi i projektligjit është legjitim, por në disa aspekte nuk respekton Kushtetutën e Kosovës. Jeton Hasani, hulumtues i lartë në këtë institut, vlerëson se projektligji përmban të meta të caktuara në aspektin juridik, duke filluar nga zgjedhja e drejtorit të përgjithshëm.

Sipas tij, drejtori i kësaj byroje është autoriteti kryesor për fillimin e procedurave të verifikimit dhe konfiskimit të pasurisë dhe zgjidhet me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi. Njëherësh, sipas tij, drejtori i kësaj byroje mund të shkarkohet lehtësisht. "Për zgjedhjen e tij mjafton shumica e thjeshtë e deputetëve të Kuvendit, që nënkupton që partitë politike në pushtet ta zgjedhin në mënyrë të lehtë. Në vend të kësaj, ne si IKD sugjerojmë që organi drejtues i byrosë të jetë kolegjal dhe me përbërje pluraliste dhe jo që të varet plotësisht një procedurë kaq e ndjeshme nga vetëm një individ, që mund të jetë i politizuar", thotë Hasani për "Radion Evropa e Lirë".

Në mesin e të metave të tjera, sipas Hasanit, është se me rastet e parashtruara nga byroja do të merret Divizioni Civil i Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe i Gjykatës së Apelit. "Aktualisht gjykata më e ngarkuar është ajo e Prishtinës. Dhe ne vlerësojmë se kompetencat e tilla duhet t'i ketë çdo divizion civil anëmbanë Kosovës ose, të paktën, në gjykatat themelore, përfshirë degët, dhe jo të kufizohet vetëm në nivel të

Prishtinës", thotë ai.

Nga Ministria e Drejtësisë thanë se pala që është pjesë e procedurës, sipas projektligjit, ka të drejtë që të paraqesë prova, fakte, ankesa dhe kërkesa në lidhje me procedurën që zhvillohet.

Konfiskimi i pasurisë së pajustificueshme konsiderohet si një ndër shtyllat në luftimin e korrupsionit në Kosovë.

Në Kosovë që nga viti 2018 ekziston Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale. Sipas këtij ligji, prokurori duhet të dëshmojë se pasuria e listuar për verifikim është pasuri e të pandehurit, ndërsa i pandehuri duhet të dëshmojë se atë pasuri e ka përfituar me burime të ligjshme, për të cilat duhet të ofrojë prova, në të kundërtën ajo konfiskohet nga gjykata.

Sipas ligjeve aktuale, konfiskimi i pasurisë nënkupton marrjen e përhershme të pasurisë që është fituar në mënyrë të kundërligjshme, sipas urdhrin të formës së prerë nga gjykata kompetente apo organi tjetër kompetent, kurse sekuestrimi nënkupton marrjen e pasurisë nga organi kompetent deri në vendimin e prerë të gjykatës.

Rreth 1.6 milion euro është vlera e aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara në vitin 2020 dhe të cilat janë në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar dhe Sekuestruar. Vlera totale e pasurisë së administruar nga kjo agjenci, që nga themelimi i saj një dekadë më parë, është afërsisht 40 milionë euro.



SHKRUAN: ISMAIL SYLA

Një mendje e padegraduar akademike

1. Nga shikimi i lajmeve pa zë, mbrëmë më ra në sy një duartrokitje frenetike e akademikëve të Kosovës. Kur u interesova se për çfarë duartrokitën, kuptova se po kremtonin alamet të arriture: botimin e përkthyer në shqip të mendimit të GjND-së dhënë 12 vjet më parë. Betejën në GjND e fitoi një ekip ndërkombëtar me mendje brilante në fushën e historisë së shqiptarëve, të historisë së kushtetutave të Kosovës dhe interpretes të shkëlqyer të Rezolutës 1244. Thelbi: Deklarata e Pavarësisë nuk është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Në këtë betejë kontributi i mendjes akademike kosovare është zero. E të krenohesh me përkthim të materialeve, thuajse janë dashur 12 vjet për t'u shqipëruar, vërtet është qesharake.

2. Në një intervistë te portali "Kallxo.com" kryetari i ASHAK-ut, Mehmet Kraja, ndër të tjera flet për dy mendje të degraduara, duke nënkuptuar mendjet e kryeministrit Rama dhe të Presidentit Thaçi (ky i yni, sipas M. K.) Më në fund nga goja e të parit të Akademisë u përmend emri i Thaçit. Por jo në kuptim pozitiv. Kjo është plotësisht në përputhje me botëkuptimin, moralin dhe formimin e tij. Nuk është i pari kryetar i ASHAK-ut që ka urrejtje patologjike ndaj UÇK-së dhe presidentit Thaçi.

3. Fryma anti-UÇK nuk është e rastit në ASHAK. Aty është një qerthull njerëzish nga periferitë e tokave shqiptare që në Kosovë kanë gjetur strehë dhe e kanë uzurpuar tash e sa dekada këtë institucion. Akademik Kraja e di mirë

statusin e ASHAK-ut, e di edhe dallimin e saj me Akademinë serbe. Vërtet Akademia serbe, bashkë me kishën ortodokse serbe dhe armatën serbe kanë bërë elaborate dhe operacione antishqiptare, që nuk u bëjnë nder, por, kush e ndal ASHAK-un që të bëjë elaborate të mira për Kosovën, për shqiptarët dhe të ardhmen e tyre?

Kush e ndalon të bëjë elaborat kundër shpifjeve të Dick Martyt, të organizojë projekte shkencore për ndriçimin e luftës së UÇK-së, të organizojë konferencë shkencore për aktakuzën monstruoze ndaj liderëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që po mbahen në burg, në Hagë.

Jo. Akademikëve të periferive të tokave shqiptare gjithçka mund t'u pushojë në zemër e në mendje por jo emri, vepra dhe kontributi historik i liderëve të UÇK-

së. UÇK dhe liderët e saj janë të huaj për ta, dhe ata janë të ftohtë, shpërfillës, cinikë përballë tyre. Jo, nuk mund të thuhet shpërfillës, sepse ja përmendet Thaçi - si mendje e degraduar, që deshi të bëjë tradhti, e që do të dënohej nga historia. Aktualisht Thaçi qëndron në burgun e Hagës.

Instinkti për ta sulmuar luanin e lidhur qenka instinkt universal i qenieve të gjalla.

4. Sa i përket mendjes tuaj të padegraduar z. Kraja duhet kuptuar se ASHAK-u e drejtuar nga ju dhe sivëllezërit tuaj nuk shquhet as për të arritura supreme shkencore, as për reflektim moral dhe intelektual. Së paku Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës në dekadën e fundit të shekullit njëzet ishte pararojë e mendimit

kombëtar dhe politik, ndërsa ASHAK-u as që mbahet mend për ndonjë kontribut as në paqe e as në luftë.

ASHAK-u aktuale, mjerisht, është pothuajse si Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës sot. I vetmi dallim, akademikët kanë privilegje materiale pakrahasimisht shumë.

5. Z. Kraja, (të gjitha librat tuaja i kam lexuar) krejt çka mbaj mend nga prodhimet e mendjes tuaj të padegraduar janë disa tregime të shkurtra shumë të mira dhe një shkrim publicistik që godet islamizmin radikal. A janë vlera supreme për statusin e akademikut?

6. Shyqyr që të ka Kosova! Nuk do ta lejosh copëtimin e saj, e as asociacionin e komunave serbe.

Si lindi qytetërimi ynë? Ja cila është hipoteza e re

Fillesat e qytetërimit tonë si njerëz lidhen shpesh me lindjen e bujqësisë. Me shtimin e prodhimit të ushqimit, u rrit edhe popullsia, u zgjerua tregtia dhe taksat. Ose të paktën kjo është narrativa dominuese.

Por disa ekonomistë kanë ngritur së fundmi një hipotezë konkurruese, e cila sugjeron se një tepricë e ushqimit në vetvete nuk mjaftonte për të nxitur kalimin nga shoqëritë e gjuetarëve-mbledhës në shtetet hierarkike që çuan në fund tek qytetërimi siç e njohim sot.

Shumë prova dhe fakte që mbulojnë një hapësirë kohore prej disa mijëra vitesh tregojnë se kjo teori është empirikisht e gabuar. Edhe kur disa pjesë të botës nisën të praktikonin bujqësinë dhe filluan të prodhonin një tepricë ushqimesh, kjo gjë nuk çoi domosdoshmërisht në një hierarki komplekse apo në themelimin e shteteve me sisteme tatimore.

Sipas kësaj teze, vetëm kur njerëzit nisën që të kultivonin ushqime që mund të ruheshin, ndaheshin, tregtoheshin dhe tatoheshin, filluan të merrnin formë strukturat sociale. Është me gjasë kjo arsyeja pse drithërat si gruri, elbi dhe orizi – dhe jo patatet – janë në origjinë të thujse gjithë qytetërimeve klasike.

Nëse një tokë ishte e aftë të kultivonte drithëra, provat tregojnë se kishte shumë më

tepër gjasa që atje të kishte struktura komplekse shoqërore. “Lehtësia relative e kultivimit të drithërave ndihmoi edhe në shfaqjen e elitave që vendosnin taksat”- shkruajnë autorët e hipotezës. Ndërkohë bimët që kanë rrënjë të thella në tokë dhe ato me zardhok të fortë, janë zakonisht bimë shumëvjeçare, ndaj nuk kanë nevojë të korren apo të shkulen për një periudhë të caktuar, por pasi të korren apo shkulen ato prishen shumë shpejt. Pë shembull në Amerikës së Jugut, bimët me rrënjë të thella dhe shumëvjeçare si kasava mund të korren gjatë gjithë vitit. Por ajo kalbet lehtë dhe është e vështirë për t’u transportuar.

Studiuesit sugjerojnë se kjo është arsyeja pse hierarkitë përtej udhëheqësve nuk u shfaqën në asnjë shoqëri të varur nga kasava, edhe nëse kishte shumë më shumë rrënjë të mjaftueshme për të ushqyer të gjithë. Nga ana tjetër, Majat ishin një nga qytetërimet më dominuese dhe më të sofistikuara në Amerikën Qendrore.

Por kjo shoqëri e lashtë nuk mbështetej vetëm tek këto kultura bujqësore. Përkundrazi, ky qytetërim ishte shumë i varur nga misri. E njëjta gjë vlen edhe për Inkasit në Ande. Lloji i ushqimit të kultivuar nga fermerët ishte qartësisht më i rëndësishëm për shoqërinë

atje sesa sasia e tij e prodhuar. Efektet e ndryshme sociale të bimëve që kanë rrënjë më të thella në tokë përkundrejt drithërave që rriten mbi sipërfaqen e tokës mund të ndihmojnë në shpjegimin se përse disa qytetërimi u bënë më komplekse, ndërsa shoqëritë e tjera mbetën si komunitete lokale ose kryeqendra.

Po ashtu kjo mund të qartësojë edhe arsyen se pse një tepricë e ushqimit në një shoqëri të gjuetarëve-mbledhës, nuk çoi domosdoshmërisht në zhvillimin e qytetërimeve. Bujqësia ishte padyshim një hap i domosdoshëm për të përmirësuar prodhimin e ushqimit. Por studiuesit dyshojnë se vetëm ato kultura që mund të sekuestroheshin lehtë çuan në ngritjen e një klase elitare.

Nëse një hierarki e fuqishme e shoqërisë do të fillonte të mblidhte taksa në formën e grurit nga fermerët pa ushqim shtesë, atëherë komunitetet bujqësore nuk do të ishin në gjendje të mbështesnin një popullsi të tillë. Si rezultat, numri i tyre me gjasë do të tkurrej, duke krijuar kështu një tepricë ushqimi për t’ua dhënë shtresave më elitare.

Nëse këta fermerë nuk do ta mbronin elitën, kjo e fundit nuk do të mbronte rezervat e tyre ushqimore nga banditët. Vjedhja e drithërave është në fund të fundit, shumë më e vlefshme se vjedhja e

ushqimeve që prishen shpejt. “Prandaj ne pajtohemi me teorinë konvencionale të produktivitetit, sipas së cilës fermerët në shoqëritë hierarkike prodhonin ushqime me tepricë. Por pretendimi ynë është se në vend të tezës se kjo tepricë gjeneron elitën, është elita ajo që gjeneron tepricë ushqimore mbi të cilën mund të lulëzojë sapo të shfaqet mundësia për ta përvetësuar atë”- shkruajnë autorët që mbështetin këtë tezë.

Për shembull një atlas i kulturave njerëzore, tregon se numri më i madh i të afërmeve të egër të kulturave të drithërave mund të gjendet në Gjysmëhënën Pjellore, për të cilën thuhet shpesh se është djepi i qytetërimit njerëzor. Ndërkohë shoqëritë historike që nuk praktikonin asnjë lloj bujqësie, gjenden në Amerikën Veri-Perëndimore, Azinë Qendrore, Australi dhe Afrikën Jugperëndimore.

Këtyre shoqërive u mungonin gjithashtu struktura komplekse hierarkike. Të dhënat nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë ofrojnë dëshmi të mëtjeshme për hipotezën e re. Ato sugjerojnë se rajonet ku drithërat janë më produktive se bimët me zardhok, kanë më shumë gjasa të organizohen si shtete me norma më të larta taksimi.

“Duke përdorur këto të dhëna të reja, ne ishim në gjendje të

tregonim se hierarkitë komplekse, u ngritën në zona në të cilat kulturat e drithërave, të cilat janë të lehta për t’u taksuar dhe për t’u shpronësuar, ishin de-fakto të vetmet kultura të disponueshme”- shpjegon ekonomisti Luixhi Paskali nga Universiteti Pompeu Fabra në Spanjë.

“Paradoksisht, tokat më produktive, ato në të cilat jo vetëm drithërat, por edhe bimët me zardhok ishin të disponueshme dhe produktive, nuk përjetuan të njëjtat zhvillime politike”.

Bashkautori i Paskalit, ekonomisti Joram Majshar, e quan atë “mallkim i bollëkut”. Në mungesë të një lloj ushqimi që mund të grumbullohet dhe mbrohet nga individë të elitës, nuk ka shoqëri të organizuar, të kontrolluar nga ligji dhe rendi. Tek e fundit, thotë Majshar, mbështetja tek kulturat bujqësore duket se ka penguar shfaqjen e shteteve dhe zhvillimit ekonomik në disa pjesë të botës, si për shembull ishujt në Paqësorin Jugor. “Vetëm aty ku klima dhe gjeografia favorizonin kultivimin e drithërave, kishte gjasa të zhvillohej hierarkia”- thekson Majshar nga Universiteti Hebraik i Jerusalemit. / Science Alert – Bota.al



Ja si diktatorët bëhen viktimat të iluzioneve të tyre



Nga Paolo ARMAROLI

Historia nuk përsëritet kurrë në të njëjtën mënyrë. Por ngjashmëria midis fushatës ushtarake në Greqi të udhëhequr nga Benito Musolini dhe fushatës në Ukrainë të udhëhequr nga Vladimir Putin janë vërtet mbresëlënëse.

Dhe Karl Marksi, duke reflektuar mbi ngjarjet në Francë në kapërcyellin e shekujve XVIII-XIX, jo më kot i mëshonte idesë se historia shfaqet për herë të parë si një tragjedi dhe për herë të dytë si komedi. Më 30 mars 1938, Dhoma e Ulët dhe Senati italian miratuan me pompozitet ligjin për Marshallin e parë të Perandorisë, titull që iu dha Viktor Emanuelit III dhe Duçes.

Po atë ditë, mes

duartrokitjeve të zhurmshe të senatorëve, Musolini i lavdëroi forcat e armatosura, italiane të cilat ai i cilësoi si ndër më të fuqishmet në botë. Dhe këtu nuk bën përjashtim as Vladimir Putin. Ai e di se njerëzit e tij kanë të ardhura shumë më të ulëta për frymë sesa evropianët dhe amerikanët.

Por nga ana tjetër, e gënjen veten se ka një ndër ushtritë më të mira në botë. Por për ta ditur nëse është i mirë apo jo, pudingu duhet shijuar. Dhe siç e dëshmojnë faktet, si Musolini po ashtu edhe Putini janë të detyruar të ndryshojnë mendje. Më 28 tetor 1940, Musolini nisi sulmin ndaj Greqisë.

Por shumë shpejt ajo ofensivë rezultoi të ishte një katastrofë. Greqia kaloi në kundërsulm dhe depërtoi

në Shqipëri. Duçja pushoi shumë nga ushtarakët e lartë. Do të duhej ndërhyrja e forcave gjermane për të imponuar kapitullimin e Greqisë në prillin e vitit 1941. Edhe Putin po sillet as më shumë e as më pak si Musolini.

Ashtu si ky i fundit besonte se grekët ishin një popull barinjsh gati për t'u dorëzuar, edhe diktatori rus u nxit nga shërbimet sekrete dhe gjeneralët e tij të besonte se Ukraina do të mposhte brenda një kohe të shkurtër. Me pak fjalë, fushata kundër Volodimir Zelenskit do të kishte qenë pak më shumë sesa një shëtitje në park.

Por kjo nuk ndodhi. Dhe duke ndjekur gjurmët e Duçes, Putin nisi spastrimet. Komandanti i përgjithshëm i fushatës u shkarkua dhe u zëvendësua

nga një gjeneral më me përvojë. Me reputacionin e të qenit një xhelat në Siri. Dhe Putini do të përulet deri në pikën sa të kërkojë ndihmë ushtarake nga Kina, ashtu si Musolini ndaj Gjermanisë naziste.

Askush nuk mund ta thotë se si do të përfundojë kjo luftë. Por fakt është se Blitzkrieg-u rus në Ukrainë ka dështuar. Lufta po vazhdon në një trajektore shumë të ndryshme nga ajo që mendohej. Trupat ukrainase po rezistojnë fort madje po marrin rezultate të papritura siç ishte fundosja e kryqëzorit rus "Mosvka", xhevahirit të ushtrisë së Putinit.

Për tiranin e Kremlinit, kjo fushatë e mjerë do të jetë fillimi i fundit. Ai u kthye kundër Xho Bajdenit, që deri dje konsiderohej si një politikan me një qasje të

butë ndaj Kremlinit.

Ai doli kundër vendeve të Bashkimit Evropian, të cilat ishin të kënaqura deri më 24 shkurt me tregtinë fitimprurëse që bënin me Carin e ri.

Dhe tani Finlanda dhe Suedia, të frikësuara nga "ariu" rus, janë gati të kërkojnë një "ombrellë sigurie" nga NATO. Ndërkohë Ukraina pret me padurim anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Një vetëvrasje kjo e Putinit.

I ndërgjegjshëm për lavditë e Stalinit, ai do të donte të fitonte më 9 maj. Kur diktatori gjeorgjian e detyroi Gjermaninë të kapitullonte në vitin 1945. Pikërisht më 9 maj por të vitit 1936, Italia pushtoi Etiopinë. Fati i diktatorëve dihet tashmë: në fund, ata bien viktimat të iluzioneve të tyre. / "Il Giornale" – Bota.al



Kosova me 4 ekipe në Evropë, kampioni direkt në fazën e parë kualifikuese në Ligën e Kampionëve

PRISHTINË, 18 PRILL - Tani kur jemi në fazën përfundimtare të garave të edicionit 2021/22 dhe në periudhën kur do të përcaktohen klubet që do ta përfaqësojnë vendin tonë në garat evropiane, konfirmohet edhe një lajm i mirë për futbollin tonë. Siç u pa edhe në ranglistën e fundit të UEFA-s, për renditjen e ligave kombëtare, Superliga e Kosovës ka shënuar përparimin e radhës, e në bazë të këtij progresi është konfirmuar lajmi, të cilin FFK-ja e ka dhënë edhe para fillimit të garave, se nga ky edicion, Kosova do të përfaqësohet me 4 klube në garat evropiane, 3 nga

kampionati dhe fituesi i kupës. Mirëpo, risia tjetër është se si rezultat i ngritjes së rangimit të ligës, kampioni i Kosovës nga ky edicion nuk do të garojë më në rundin parakualifikues, por do të shkojë direkt në rundin e parë kualifikues të Ligës së Kampionëve. Përparimi i ligës, përfaqësimi me më shumë klube në garat evropiane dhe rritja e cilësisë në kuadër të garimit të brendshëm, është një tjetër dëshmi se futbollit i Kosovës po shënon rritje në çdo aspekt, e që është edhe mision kryesor i Federatës së Futbollit të Kosovës dhe presidentit Agim Ademi.



“Meqë jemi në fazën përfundimtare të garave kampionale, dhe kohës kur do të përcaktohen klubet që do ta përfaqësojnë futbollin tonë në garat evropiane, konfirmohet edhe një lajm i mirë për futbollin tonë. Siç u pa edhe në ranglistën e fundit

të UEFA-s, për renditjen e ligave kombëtare, liga e Kosovës ka shënuar përparimin e radhës. Dhe në bazë të këtij përparimi, konfirmohet lajmi që ne FFK-ja e ka dhënë edhe para fillimit të edicionit, se nga ky edicion, liga jonë do të përfaqësohet

me 4 klube. 3 nga kampionati dhe fituesi i kupës”, ka thënë Ademi.

“Mirëpo risia tjetër është se si rezultat i ngritjes së rangimit të ligës, kampioni i Kosovës nga ky edicion nuk do të garojë në rundin para kualifikues, por direkt në rundin e parë kualifikues të Ligës së Kampionëve. Përparimi i ligës, përfaqësimi me më shumë klube në garat evropiane dhe rritja e cilësisë në kuadër të garimit të brendshëm, është një tjetër dëshmi se futbollit i Kosovës po shënon rritje në çdo aspekt, që është edhe mision kryesor i Federatës së Futbollit të Kosovës”, ka shtuar Ademi.

Prishtina triumfon në finalen e tretë



PRISHTINË, 18 PRILL - Prishtina ka mundur Penzën me rezultat 87:68 (16:19, 36:14, 13:20, 22:15), në ndeshjen e tretë finale të “play-off”-it në Superligën e Femrave. Tashmë rezultati është 2:1 për skuadrën pejane. Ndeshja e ardhshme zhvillohet në Pejë të premten. Skuadra mysafire e nisi ndeshjen për mrekulli, me një seri të jashtëzakonshme 0:13, megjithatë, me kalimin e

minutave vendaset u rikthyen, duke ngushtuar shifrat, ku çereku i parë përfundoi 16:19. Prishtinaset vazhduan me lojë të mirë në periodën e dytë, ku shkëlqyen në mbrojtje dhe në sulm, për tu shkëputur në rezultat, derisa pjesa e parë përfundoi 52:33. Pejanet nuk u dorëzuan dhe në periudhën e tretë dalëngadalë ngushtuan shifrat, duke e bërë ndeshjen më interesante, kurse shifrat

pas 30 minutash ishin 65:53. Në dhjetë minutat e fundit, kampionet u munduan të bëjnë rikthimin e madh, por nuk ia arritën qëllimit dhe Prishtina triumfoi 87:68. Te Prishtina u dalluan Stasha Carey me 16 pikë e dhjetë kërcime dhe Tynice Martin me 30 pikë, kurse te Penza u dalluan Rael Whitsitt me 17 pikë e 16 kërcime dhe Valbona Bytyqi me 16 pikë e 11 kërcime.

Vëllaznimi në Superligë

PRISHTINË, 18 PRILL - Vëllaznimi ka shënuar fitore edhe në ndeshjen e dytë të “play-off”-it të Ligës së Parë, duke mundur Prishtinën e Re me rezultat 65:76 (19:17, 20:21, 17:15, 9:23), duke u rikthyer në Superligë. Çereku i parë ishte i barabartë, duke përfunduar me shifrat 19:17, ndërsa lojë interesante u zhvillua edhe në periudhën, ku të dy skuadrat luftuan për çdo top, duke e dëshiruar fitoren, ndërsa

skuadrat shkuan në pushim me rezultat 39:38. Në periodën e tretë, prishtinasit kishin disa herë epërsi deri në shtatë pikë, por që ngushtojë nga kuqezinjtë, ndërsa shifrat në semafor pas 30 minutash ishin 56:53. Edhe në dhjetë minutat e fundit u zhvillua lojë interesante, megjithatë, në momentet vendimtare, kuqezinjtë ishin më të mirë, duke triumfuar 65:76. Te Prishtina e Re u dallua Dion

Haxhosaj me 24 pikë e 20 kërcime, kurse te Vëllaznimi u dallua Michael Green me 33 pikë e shtatë kërcime. Kupën kapitenit të Vëllaznimit, Driton Rraci ia dorëzoi kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, ndërsa medaljet i ndan kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, Anëtari i Bordit të FBK-së, Leart Hoxha dhe Komisari i Garave të FBK-së, Faton Kurshumlja.



Ronaldos i vdes djali

MANCHESTER, 18 PRILL - Cristiano Ronaldo ka njoftuar për vdekjen e njërit prej binjakëve të porsalindur. Sulmuesi portugez e bëri të ditur këtë përmes një postimi në llogarinë e tij në “Instagram”. Ronaldo me

pikëllim njoftoi për vdekjen e djalit të tij, teksa bëri të ditur për ardhjen në jetë të vajzës. Djali i çiftit vdiq gjatë lindjes së Georgina Rodriguezit. “Me pikëllimin tonë më të thellë duhet të njoftojmë se djali ynë ka ndërruar jetë. Është

dhimbja më e madhe që mund të ndiejë çdo prind. Vetëm lindja e vajzës sonë na jep forcën për ta jetuar këtë moment me pak shpresë dhe lumturi. Dëshirojmë të falënderojmë mjekët dhe infermierët për kujdesin dhe

mbështetjen e tyre eksperte. Të gjithë jemi të shkatërruar nga kjo humbje dhe me mirësi kërkujmë privatësi në këtë kohë shumë të vështirë. Djali ynë, ti je engjëlli ynë. Ne do të të duam gjithmonë”, ka shkruar Ronaldo.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM
PËR TË RRITUR
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE
I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND
ADULT EDUCATION

Njoftim

Hapja dhe vlerësimi i ofertave për ekskursion në Shqipëri për Qendrën e Kompetencës “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë, shtyhet për ditën e marte (19.04.2022), pasi që sipas datës së shpalljes i bie që hapja dhe vlerësimi të bëhet ditën e shtunë, mirëpo është ditë pushimi.

NJOFTIM ZBRITJE MALLI DERI 75 %

Biznesi individual me numër Unik Identifikues 810497398 me seli në Llapna Sell dhe nr. kontakti 044777778, për arsye të likuiditetit, njofton të interesuarit qytetarë si persona fizik apo juridik mund të blejnë produkte kozmetike grimi të brendeve botërore MAX FACTOR, ARTDECO, parfuma, deodorante, qumësht trupi etj, të firmave botërore BOSS, BALDESSARINI, D&G, Lacoste, Moschino, Valentino, Versace, ngjyra flokësh, pajisje tretmani dhe mirëmbajtje floku të prodhuesit Italian DIKSON.

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek “**REB BULLI**”, në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:
044-514-373 dhe 044-199-707.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Emin Haziraj shpall te pavlefshme dy dëftesat shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Sylejman Ramanaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Naim Frasheri " Kobaje.
- ▶ “Sri Consulting” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811889552.
- ▶ “Vezë Fan” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811889726.
- ▶ Rebeka Lohaj shpall të pavlefshëm letërnjoftimin me numër: 1174178352 të lëshuar nga MPB-ja me datë 07.09.2016.
- ▶ Avdyl Hajdaraj nga Gjakova shpall të pavlefshme gjimnazit “Hajdar Dushi”-Gjakovë.
- ▶ Endrit Halilaj nga Lipoveci i Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M.U ‘Shaban Golaj’.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

